

Fluturimi teator i Kosovës mbi Beograd



Publikuar: 14.12.2012 - 09:40

Beograd, 14 dhjetor - Është kohë e pasdites dhe dëborat duket se mbulon gjithçka në kryeqytetin serb. Një pjesë e stafit të shfaqjes "Fluturim mbi teatrin e Kosovës", prej letrave të bardha ndërtojnë dhjetëra aeroplanë. Në anën tjetër, duke u ngrohur afër sobës së ndezur me dru, producenti Jeton Neziraj, drejtor i Qendrës Multimedia të Prishtinës, pranë një tavoline të gjatë flet për projekte të reja. Por, sqaron ethet e shfaqjes për premierën në Kosovë dhe vendet e tjera ku është dhënë, në Tiranë e Shkup. "Kemi dhënë disa njoftime për shtyp në të cilat kemi thënë se është realizuar në bashkëpunim me Qeverinë, por edhe se kryeministri i Kosovës do të luajë në premierën e Beogradit. Një pjesë e kanë besuar këtë", rrëfen Neziraj. "Ne kemi thënë se kryeministri ka luajtur si fëmijë edhe në shfaqjen 'Kësulëkuqja'", shton ai.

Rrugët janë të bllokuara dhe pak njerëz duket se kanë marrë guximin të sfidojnë temperaturat në minus. Nuk ka policë para Qendrës për Dekontaminim Kulturor (QDK), të udhëhequr nga Borka Paviçević, e cila është quajtur "ambasada e Kosovës", në kulturë. Shqetësimi i grupit dhe i nikoqirëve është më shumë se sa njerëz do të vijnë për shkak të motit. Nuk është bërë reklamë për shfaqjen, por gjithnjë gjenden fanatikët e shfaqjeve të munguara.

Salla, që ka rreth dyqind vende, pothuajse është mbushur përplot dhe aktorët në skenë fillojnë interpretimin e rrëfimit kur për shpalljen e pavarësisë së Kosovës, një sekretar, burokrat klasik i shtetit, kërkon nga drejtuesit e Teatrit të Kosovës të përgatisin një shfaqje për festimet. Meqë teatri është në krizë dhe pa mjete financiare, një shumë prej njëzet mijë eurosh është e mirë. Në rrugëtim, komedia tregon nevojat për të sforcuar festën dhe për ta kontrolluar atë, të mos jetë as shumë patriotike, por të tregojë udhëtimin e një populli deri në ditën e pavarësisë. Kjo komedi përfundon me dehjen fatale të protagonistit që luan në skenë rolin e kryeministrit apo fjalimin e tij dhe përfundon me akuzat për realitetin dhe arritjet.

Shfaqja, nën regjinë e Blerita Rrustemit, ku luajnë Bajrush Mjaku, Anisa Ismaili, Adrian Aziri, Ernest Malazogu dhe Adrian Morina, nën përcjelljen e muzikantëve italianë Susanna Tognella (violë) dhe Gabriele Marangoni (harmonikë), ngërthen në vete një parodi të suksesshme të nacionalizimit dhe ngjarjeve të ndodhura në Kosovë, një stil që përkundër faktit që mund të krijojë përshtypjen se është realizuar për t'i pëlqyer publikut jashtë

originës, në një realizim bashkëkohor arrin të kapë guximin e realizuar në vende të tjera të rajonit dhe bëhet pikë reference dhe krahasuese.

Shfaqja është duartrokatur dhe është vlerësuar nga publiku si një risi në marrëdhëniet apo shkëmbimet kulturore të Kosovës dhe Serbisë, pikërisht për faktin që kjo shfaqje tregon se një shoqëri merret me vetveten dhe i mundëson publikut të shikojë pa paragjykim, ngjarjet brenda një shoqërie.

"Me këtë shfaqje, në asnjë mënyrë nuk e vëmë në pikëpyetje pavarësinë e Kosovës", tha Neziraj, duke sqaruar se një pjesë e opinionit kanë mendime kundërshtuese. "Fakti që e shfaqim në Beograd, para publikut këtu është vetëm një sfidë pasi këtu ka më shumë kritikë", shtoi ai.

Pas shfaqjes është mbajtur një debat lidhur me tematikën e saj, por edhe për bashkëpunimin kulturor në mes Kosovës dhe Serbisë. Në publik ka pasur mjaft shikues profesionistë, të cilët e kanë vlerësuar shfaqjen edhe si një arritje që në Serbi ende nuk ekziston. Megjithatë, bashkëpunimi kulturor ngelet "e drejtë" ekskluzive në mes të organizatave dhe hapësirave alternative, ndonëse sipas një pjese, shtrëngimi i duarve të kryeministrave Hashim Thaçi dhe Ivica Daçiq, shuan hapësirën për emërtime të tradhtarëve të kombit në këtë relacion (më gjerësisht sot në "Kohën Ditore").